



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 69, datë 7.10.2016

Për

**“DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 38, DATË 23.05.2016 “PËR
“MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË
CAKTUAR PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME NR.1 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT,
DREJTORINË E PËRGJITHSHME NR.2 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT DHE
AGJENCINË E PARQEVE DHE REKREACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1 shkronja “b”, nenit 23 pika 9, nenit 27 pika 1, nenit 54 shkronjat “ç”, “dh”, nenit 55 pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 140, nenit 149 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 7, datë 30.03.2009 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë së Tiranës, përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 41, datë 23.09.2015 “Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”; Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 31.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 38, datë 23.05.2016 “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtorinë e Përgjithshme nr.2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, Urdhrit nr. 14431, datë 05.10.2015 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”, (i ndryshuar); Urdhrit nr.3188/1, datë 01.02.2016 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit nr.56, datë 24.12.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa Institucioneve në Varësi të Bashkisë së Tiranës (i ndryshuar); Urdhrit nr.3185, datë 01.02.2016 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.56, datë 24.12.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative të disa institucioneve në Varësi të Bashkisë së Tiranës”; kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit me nr. Prot. 28197 datë 20.09.2016, kërkesës së Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me nr. Prot. 29398, datë 29.09.2016, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Pas pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 38, datë 23.05.2016 “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e

Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtorinë e Përgjithshme nr.2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”, të shtohet pika 1/1 si vijon:

1/1 Të miratojë një numër shtesë prej 76 punëtorë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit për një periudhë 3 mujore (Tetor- Dhjetor) për mbjellje e kultivim bimësie, me pagë bruto 30.000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj.

2. Pas pikës 3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 38, datë 23.05.2016, “Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Qytetit, Drejtorinë e Përgjithshme nr.2 të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit” të shtohet pika 3/1 si vijon:

3/1 Të shtyhet për një afat dy mujor (tetor – nëntor) kohëzgjatja e periudhës së punësimit për punonjësit me kontratë me afat të caktuar për vitin 2016 të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit.

3. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit për vitin 2016.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI